REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 666/22
Datë/Datum. 01.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli **eks. Shqyrtues** **Arben Lajqi** **eks.Teknik**	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***29.11.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***01.12.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***666/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.11.2022, OE ankues **B&D "Engineering" shpk-Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **666/22,** kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: ***"Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregullueseper furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3,A4,A5.",*** me nr.të prokurimit: KEK-22-6439-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur -furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës Çmimi më i ulët, vlera e parashikuar e kontratës: **37 570,00 Euro.**

Njoftimi për kontratë: 29.06.2022
Hapja e ofertave: 01.08.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK: 27.10.2022
Kërkesa për rishqyrtim me dt. 31.10.2022

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt. 07.11.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti shqyrtues-teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 28 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 44.5 i RRUOPP-së.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Të nderuar ju njoftojmë se ne përmes sistemit të prokurimit publik në datë 27.10.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se "ka mungese te ofertave te përgjegjshme".

Po ashtu, në po të njëjtën datë kemi pranuar nga AK dokumentin "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar" drejtuar kompanisë sonë "B&D ENGINEERING SHPK" përmes së cilës AK-ja njofton se ju jeni eliminuar për shkak te arsyeve si ne vijim:

Ne DT Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME është kërkuar:

1.Garancioni i prodhuesit te pjesëve rezerve te valvave kryesore per (12) muaj për pune normale.

OE B&D Engineering sh.p.k ka ofruar garancion nga prodhuesit PERSTA dhe ARCA për pjesët rezerve përveç për pozicionin: 5-154573679 Kushineta aksiale (SKF) origjinale, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660).

Pasi që nuk jemi pajtuar me arsyetimin e ngritur nga AK mbi eliminimin e ofertës sonë, bazuar ne te drejtën qe parasheh ligji i prokurimit ne Republikes e Kosovës, neni 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke qene se nuk pajtohemi aspak me këtë arsyetim te AK për eliminimin e ofertës sonë, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Ne ditën e hapjes se tenderit ne kemi dorëzuar dokumentacionin tekniko-financiar konform "Kërkesave mbi përshtatshmërinë profesionale" dhe "Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale".

Po ashtu kemi dorëzuar dokumentacionin përkatës me qellim përmbushjen e kritereve teknike te cekura nga AK ne paragrafin e fundit te ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME.

Ne kuadër te përmbushjes se kriterit Pika 1:

"1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për (12 muaj) për punë normale. ."

Ne së bashku me ofertë kemi dorëzuar garancionet e lëshuara nga 2 prodhuesit me të cilët ne kemi ofertuar në këtë procedurë.

Saktësisht është dorëzuar ditën e hapjes se tenderit date 01.08.2022:

- Garancioni nga prodhuesi "STAHL ARMATUREN PERSTA GMBH"
- Garancioni nga prodhuesi "ARCA – REGLER GMBH"

Te dy këta prodhues janë njëkohësisht edhe prodhuesit ORIGJINAL të pjesëve të valvuleve kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl, A3, A4, A5, produkte këto objekt prokurimi në këtë lëndë.

Nga dokumentacioni që kemi dorëzuar, ne i kemi bërë me dije AK-së se oferta e dorëzuar nga ne i referohet mallrave të prezantuara nga vetëm dy prodhues (PERSTA dhe ARCA), pra në ofertën tonë nuk ka një prodhues të tretë, i cili do duhej të dorëzonte gjithashtu një garancion mbi mallrat e ofertuar.

Arsyeja e eliminimit tonë nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka cekur se mungon garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore, saktësisht për pozicionin e Kushinetës aksiale (SKF) nuk ka të beje fare me ofertën teknike të dorëzuar nga ne.

Duhet cekur se nga AK-ja ne kemi pranuar "LETER STANDARDE E KERKESES PER SQARIMIN E TENDERIT" me dt. 07.09.2022 gjatë fazës së vlerësimit të kësaj procedure nga KVO e AK (shiko dokumentin ne shtojcën bashkëngjitur), ndërsa ne i kemi kthyer përgjigjje Autoritetit Kontraktues me sqarimet përkatëse duke ju sqaruar si në vijim:

Kështu, saktësisht referuar pozicionit 9 i DST 154573679 Kushineta aksiale (SKF) origjinale, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660), te ngritur si arsyetim nga AK-ja për eliminimin e ofertës sonë, ne i kemi dorëzuar AK-së dokumentin "Poz.5,6,7,8,9 Prerja terthore ARCA nr.269687-te nenvizuara"(shiko shtojcën bashkëngjitur).

Ne këtë dokument, i cili i përket prodhuesit ARCA REGLER (garancioni 12 mujor i të cilit është dorëzuar që në fazën e tenderimit), është nënvizuar dhe definuar saktë edhe Poz. 9, duke bërë madje edhe nënvizimin dhe shënimin përbri pozicionit.

Më poshtë po ju bashkangjesim dëshminë:

13 Stückliste

empfohlene Ersatzteile sind mit einem * gekennzeichnet

Position		Benennung	
1		Gehäuse	
2		Deckelflansch	
20	*	Sitz	
26	*	Kegel (kompl.)	
48	*	Packungsring	→ Poz. 5
50	*	Spindel	→ Poz. 8
52	*	Kugel	
57	*	6-kt Mutter	
58	*	Dichtung	
60		Zylinderrohr	
65		Führungsbuchse	
80	*	Schraube(nbolzen)	
81	*	Mutter	
143	*	Dichtung	→ Poz. 6
144	*	Dichtung	→ Poz. 7
150		Nutmutter	
152		Stopfbuchsschraube	
154	*	Grundring	
156	*	Packungssatz	
164	*	Gleitlager	→ Poz. 9
177	*	Kolbenring	

Pra pozicionin nr.9, ne e kemi cekur se i njëjti i prezantohet autoritetit kontraktues si një produkt final i lëshuar nga fabrika prodhuese.

Ju bëjmë me dije se pozicionet e ofertuar nga ne sipas prodhuesit ARCA janë zërat si me poshtë:

Poz.1, Poz. 2, Poz. 3, Poz. 4, Poz. 5, Poz. 6, Poz. 7, Poz. 8, Poz. 9, pra konform kërkesës së AK – së në dosje të tenderit. Pozicioni i me të cilin kemi ofertuar ne sipas prodhuesit PERSTA është Poz. 10, ashtu sipas kërkesës se AK-së në dosje të tenderit.

Andaj arsyetimi i AK-së se kinse për pozicionin nr. 9 nuk është dorëzuar një garancion nga prodhuesi, është jo i drejtë, i pa bazuar dhe si i tillë nuk mund dhe nuk duhet të merret në konsideratë, pasi që ne kemi ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, ku e kemi prezantuar edhe katalogun nga prodhuesi ku është i përfshirë edhe pozicioni nr.9.

Nga ana jonë, për sa kohë që oferta teknike është punuar në bashkëpunim me prodhuesit e pjesëve origjinale të këtyre valvulave, i konfirmojmë AK-së se levrimi i Kushinetës aksiale ne rast se oferta jonë shpërblehet me kontratë do të ofrohet saktësisht sipas kërkesave të AK, kushinete aksiale për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660).

Ne me dt.07.11.2022 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se kinse e njëjta është pa bazuar, mirëpo që nuk ka dhënë fakte konkrete duke u bazuar në dispozita ligjore për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

E njëjta në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim vetëm i ka përsëritur arsyetimet e njëjta sikurse tek letra standarde për tenderues të eliminuar, duke mos i kundërshtuar pretendimet tona me fakte dhe dëshmi konkrete të bazuara në dispozita ligjore.

Ne edhe një herë po e sqarojmë faktin se ne kemi ofertuar me dy prodhues për të gjitha pozicionet e specifikuara nga AK, ku kemi prezantuar edhe garancionet nga prodhuesit. Pikërisht garancioni nga prodhuesi ARCA, të cilin e kemi prezantuar për pozicionet nga nr.1 deri në nr.9, në të njëjtin është specifikuar edhe emri i aktivitetit të prokurimit ku theksohet qartë se të njëjtit garantojnë për produktet të cilat kemi ofertuar.

Mirëpo AK-ja pasi që nuk ka mundur të kundërshtojë pretendimin tonë ankimor e njëjta tani në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e cek se kinse për pozicionin nr.9 OE nuk ka deklaruar prodhuesi e kushinetës dhe nuk ka vizatim as katalog me përshkrim teknik për kushinetën.

Ky konstatim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi cekur që garancionin i lëshuar nga prodhuesi ARCA është për pozicionet nga nr.1 deri tek poz. Nr.9, fakt ky që tregon qartë se arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Edhe një herë po e sqarojmë faktin se prodhuesi ka marr përgjegjësinë e garancionit për të gjitha produktet për pozicionet e lartcekur, andaj vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, po ashtu i pa mbështetur në dispozita ligjore konkrete.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet e lartcekura, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Në këtë tender , ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

Njëkohësisht autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE B&D Engineering shpk si e bazuar,

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

		Kërkesat e përshtatshmërisë: **1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65; 2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit; 3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit; Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmrisë, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.**
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit; 3.Regjistrimi i numrit fiskal**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit); 2.Kopja e certifikatës TVSH-se; 3.Kopja e certifikatës numrit fiskal.**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1.Çertifikate te produktit ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet 2. Katalogë pjesë të katalogut apo prezantime grafike (vizatimet) dhe ose fotografi të produkteve për furnizim, bashkangjitur përshkrimeve teknike detale për artikujt qe ofertoni**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Certifikatë Standard ISO 9001-2015, të prodhuesit për produktet e ofruar. 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut dhe sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt.**

Aneksi 1 ***SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME***

Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në bl.(A3,A4,A5).

Adresa për dërgim	

2 Pozicionet, Nomenklatura dhe përshkrimi i të dhënave - Duhet të mbushen nga **Divizioni që e lëshon dhe Zyrja e Prokurimit.**

Poz.	Nomenklatura - Përshkrimi	NjS	Sasia	Koha e	ÇNj	Çmimi në EURO
1	*Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese - Tipi i valvës : 6H7 – L1/ DN250/200/250 ; PN250 / Nr. 328113*	*Sipas specifikimi teknik*	*Sipas specifikimi teknik*	*90 ditë*	*Sipas specifikimit teknik*	
2	*Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese - Tipi i valvës : 127 – L1/ DN200/250 ; PN250 / Nr. 269687*	*Sipas specifikimi teknik*	*Sipas specifikimi teknik*	*90 ditë*	*Sipas specifikimit teknik*	
3	*Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore shiberike - Tipi i valvës : Schieber DSK 26.25 – 700 JT 42.2 / DN250/200*	*Sipas specifikimi teknik*	*Sipas specifikimi teknik*	*90 ditë*	*Sipas specifikimit teknik*	

Termet e dërgesës	**DDP**	**DAP**	**DAT**	**CIP**	**CPT**	**EXË**

3 Të dhënat komerciale - Duhet të mbushen nga **Prokurimi**

Lloji i Bler.	Lloji i Tenderi	Procedura	Përgjegjës Teknik	Zyrtari përgjegjës ne ZEP	Furnizuesi i zgjedhur	E aprovuar prej (nënshkrimi)

Shënim :

Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në bl.(A3,A4,A5), *sipas specifikimit :*

** nr.fletëve (1/1 deri 1/9).*

Specifikimi për ***: Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në bl.(A3,A4,A5).***

A.) - Tipi i valvës : 6H7 – L1/ DN250/200/250 ; PN250 / Nr. 328113
Prodhues i valvave ''ARCA'' (Gjermani).

Nr.	*Nomenkla - tura*	***Përshkrimi***	*Njësia*	*E kërku ar*
1	*154573650*	*Unaza shtytëse (distancuesi) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.182, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1068511; 1068512).*	*copë*	*4*
2	*1545736 52*	*Puthitësi metalik (karika) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.180, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1068511; 1068512).*	*copë*	*4*
3	*1545736 53*	*Puthitësi metalik (karika) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.143, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1068511; 1068512).*	*copë*	*4*
4	*1545736 59*	*Foleja (sici) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.20, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1068511; 1068512).*	*copë*	*2*

1/2

B.) - Tipi i valvës : 127 – L1/ DN200/250 ; PN250 / Nr. 269687
Prodhues i valvave ''ARCA'' (Gjermani).

Nr.	*Nomenklatur a*	***Përshkrimi***	*Njësia*	*E kërku ar*
1	*1545736 73*	*Puthitësi metalik (karika) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi,*	*copë*	*2*

		pozicioni nr.48, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1034659; 1034660).		
2	*1545736 74*	*Puthitësi metalik (karika) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.143, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1034659; 1034660).*	*copë*	*2*
3	*1545736 75*	*Puthitësi metalik (karika) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.144, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1034659; 1034660).*	*copë*	*2*
4	*1545736 77*	*Boshti (shpindla) për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.50, sipas vizatimit të valvës rregulluese , numri i valvave (1034659; 1034660).*	*copë*	*1*
5	*1545736 79*	*Kushineta aksiale (SKF) origjinale, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660).*	*copë*	*2*

C.) - Tipi i valvës : Schieber DSK 26.25 – 700 JT 42.2 / DN250/200 ; Prodhues i valvave ''PERSTA'' (Gjermani).

Nr.	*Nomenklatura*	***Përshkrimi***	*Njësia*	*E kërkuar*
1	*1545736 80*	*Boshti (shpindla) për valvat kryesore rregulluese shiberike për furnizimin e kazanit me ujë demi, pozicioni nr.400, sipas vizatimit të valvës rregulluese shiberike.*	*copë*	*2*

*Kërkesës ia bashkangjes vizatimet e valvave kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi me shenimet përkatëse të valvave për tipet e valvave: (**6H7 – L1/ Nr. 328113**); (**127 – L1/ Nr. 269687**) dhe (**Schieber DSK 26.25 – 700 JT 42.2**), të skenuara.*

Kriteret teknike që duhet të përmbush çdo Operator Ekonomik :

1. *Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për (12 muaj) për punë normale.*
2. *Pasi që nuk i posedojmë vizatimet me prerjen tërthore për këto pjesë, O.E. është i obliguar që me rastin e liferimit të sjellë vizatimin e pjesëve të kërkuara me prerje tërthore dhe dokumentacioni të jetë në gjuhen shqipe.*
3. *Atestet e pjesëve të domosdoshme me rastin e liferimit*
4. *Deklarata per preardhjen e mallit*

/4

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 25.10.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a **anulon** këte aktivitet të prokurimit në munges të ofertave të përgjegjshme.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME KETE PROCEDURE

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur- furnizim, kriteri i dhënjes së kontratës Çmimi më i ulët.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër **anulimit** të aktivitetit të prokurimit dhe eliminimit të ofertës të OE ankues B&D "Engineering" shpk-Prishtinë përkatësisht kundër arsyetimit te eliminimit ku AK – Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, përmes letrës standarde te datës 25.10.2022, shprehimisht ka potencuar: *"Ne DT Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUSHME është kërkuar:*

1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezerve të valvave kryesore për (12 muaj)për punë normale.

OE B&D "Engineering" shpk ka ofrua garancioni nga prodhuesit PERSA dhe ARCA për pjesetë rezervë përveç për pozicionin:

5-154573679 Kushineta aksiale (SKF)origjinale për valvat kryesore rregulluese për funizimin e kazanit me ujë demi numri i valvave (1034659;1034660).

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) B&D "Engineering" shpk-Prishtinë

Ekspertja shqyrtuese/teknik sqaron se për këtë procedurë të prokurimit, AK KEK me datë 25.10.2022 ka nxjerr Njoftim mbi Vendimin e AK-së duke e anuluar këtë procedurë të prokurimit me arsyetimin se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, kurse përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar e njofton OE ankues se:

1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezerve të valvave kryesore për (12 muaj)për punë normale.

OE B&D "Engineering" shpk ka ofrua garancioni nga prodhuesit PERSA dhe ARCA për pjesetë rezervë përveç për pozicionin:

5-154573679 Kushineta aksiale (SKF)origjinale për valvat kryesore rregulluese për funizimin e kazanit me ujë demi numri i valvave (1034659;1034660).

Kurse OE ankues me datë 31.10.2022 parashtron kërkesë për ri shqyrtim pranë AK-së, duke e kundërshtuar vendimine AK-së për anulim të procedurës, si dhe jep arsyet e kundërshtimit të këtij vendimi si më poshtë:

Ne kuader te permbushjes se kriterit Pika 1:

"1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për (12 muaj) për punë normale. ."

I jane dorezuar Autoritetit Kontraktor garancionet e leshuara nga 2 prodhuesit me te cilet ne kemi konkuruar ne kete procedure.

Saktesisht eshte dorezuar diten e hapjes se tenderit date 01.08.2022:

1. Garancioni nga prodhuesi "STAHL ARMATUREN PERSTA GMBH" –
2. Garancioni nga prodhuesi "ARCA – REGLER GMBH"

Te 2 keta prodhues jane njekohesisht edhe prodhuesit ORIGJINAL te pjeseve te valvulave kryesore rregulluese per furnizimin e kazanit me uje demi ne Bl. A3, A4, A5, mallra keto objekt prokurimi ne kete lende.

Pra, nga dokumentacioni i dorezuar, i eshte bere me dije AK se oferta e dorezuar nga ne i referohet mallrave te ofertuara nga **vetem 2 prodhues (PERSTA dhe ARCA), nuk perfshihet ne oferten tone asnje prodhues i trete**, i cili do duhej te dorezonte gjithashtu nje garancion mbi mallrat e ofertuar.

Lidhur me këtë kërkesë për ri shqyrtim, AK me datë 07.11.2022 nxjerr vendim sipas kërkesës për ri shqyrtim duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesën për ri shqyrtim, me arsyetimin se:

AK edhe njëherë konstaton se në DT është kërkuar:

Kushsineta aksiale (SKF) origjinake, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660). Copë 2

OE B& D ENGINEERING SHG.P.K. ka ofruar garancion nga prodhuesi PERSA dhe ARCA për pjesët rezervë përveç për pozicionin:

5-154573679 Kushsineta aksiale (SKF) origjinale, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660)

Për këtë pozicion OE nuk e ka deklaruar prodhuesin e kushinetës dhe nuk ka vizatim as katalog me përshkrim teknik për këtë kushinetë.

Pas shqyrtimit të kërkesave të dosjes së tenderit dhe tenderit të dorëzuar nga OE ankues, **ekspertja shqyrtuese/teknik** sqaron se OE ankues me tender ka bashkangjitur 2 garancione nga dy prodhues:

ANNEX 1. MANUFACTUR'S GUARANTY FORM
According to Section 29 of Law Nr.2003/17, Law on Public Procurement

Date, 18.07.2022

To: **KOSOVO ENERGY CORPORATION JSC**
Rr. Nënë Tereza, 36
Prishtinë, 10 000
KOSOVË

WHEREAS **Stahl-Armaturen PERSTA GmbH** who is established and reputable manufacturer of all kind of valves for power plants, industry etc., having offices at: Mülheimer Straße 18, 59581 Warstein, Germany

We hereby extend our full guarantee and warranty of 12 Months for our offered products by:

N.T.N."B&D Engineering"
Add. Rr."Lidhja e Pejes nr.69"
10 000 Prishtinë, Kosovo

will be in accordance with Technical Specifications based on tender **Procurement No. KEK-22-6439-1-2-1 and Inner No. KEKO-22-232-121 "Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregullueseper furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5"** for the above goods manufactured by us

Stahl-Armaturen PERSTA GmbH
Mülheimer Straße 20
D-59581 Warstein

i.V.

MANUFACTUR'S WARRANTY FORM

Date, 12.07.2022

To: KOSOVO ENERGY CORPORATION JSC
Rr. Nënë Tereza, 36
Prishtinë, 10 000
KOSOVË

WHEREAS **ARCA- REGLER GmbH** who are established and reputable manufacturers of all kind of valves, pneumatically and electrically-activated control valves having Factories at:
Kempener Straße 19,
47918 Tönisvorst, Germany

We hereby extend our full guarantee and warranty of **12 months** for our offered products by

N.T.N."B&D Engineering"
Add. Rr."Lidhja e Pejës nr.69"
10 000 Prishtinë, Kosovo

will be in accordance with Technical Specifications based on tender Procurement No. **KEK-22-5439-1-2-1** and Inner No. **KEKO-22-233-121** "**Furnizim me pjesë rezerve për valvat kryesore magistuesepër furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5**" for the above goods manufactured by us.

With kind regards,

Linë 01.08.2022

NOVAMAT

1. Garancioni nga prodhuesi "STAHL ARMATUREN PERSTA GMBH", dhe
2. Garancioni nga prodhuesi "ARCA – REGLER GMBH".

Kriteret teknike që duhet të përmbush çdo Operator Ekonomik :

1. *Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për (12 muaj) për punë normale. .*
2. *Pasi që nuk i posedojmë vizatimet me prerjen tërthore për këto pjesë, O.E. është i obliguar që me rastin e liferimit të sjellë vizatimin e pjesëve të kërkuara me prerje tërthore dhe dokumentacioni të jetë në gjuhen shqipe.*
3. *Atestet e pjesëve të domosdoshme me rastin e liferimit*
4. *Deklarata per preardhjen e mallit*

/4

Eksperti teknik pas shqyrtimit në detaje të lëndes së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit si dhe duke u bazuar në dispozicion jep këtë mendim si në vazhdim:

Në pretendimet ankimore të OE ankues për shkeljet të cilat i ka bërë AK me nenet e lartcekura eksperti teknik jep pergjigjen si në vazhdim:

-AK tek Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme qarte specifion kerkesat e veta dhe te njejtat i percakton dhe kërkon garancion per produktet e ofertuara.

Ne letren standarde per sqarimin e tenderit te dates 07.09.2022 AK kerkon nga OE te nenvizohen produktet e ofruara dhe i njejti i pergjigjet me daten 09.09.2022 **dhe i nenvizon artikujt te cilet i ka ofertu duke përfshi edhe kushineten SKF tek pozicioni 9**.

Duke marrë për bazë garancionin të cekura më lartë që prodhuesi i valvave ka dhënë për të gjithë artikujt e ofertuar konsideroj qe i njëjti garancion vlenë edhe për kushinetat SKF të kërkuara. Këtu bazohen edhe në kerkesat qe AK i ka kerkuar janë për punë normale dhe kerkesat tjera në vazhdim janë në rast të liferimit.Poashtu garancionet dhe atestet origjinale dorëzohen se bashku me produktet e ofruara.

Megjiatë sipas kërkesës së prezantuar më lartë, AK te pika 1 e Kritereve teknike që duhet përmbushur e ka cekur "Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për 12 muaj për punë normale", ndërsa OE ankues në garancitë e prezantuara më lartë ceket se janë prodhues të gjitha llojeve të valvave si dhe japin garanci 12 muaj për produktet e ofruara. Andaj, ekspertja shqyrtuese/teknik konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me kërkesat kundrejt ofertave, përkatësisht ne harmoni me nenin 59 të LPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES-TEKNIK

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues B&D "Engineering" shpk-Prishtinë të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri Vlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a

Panelit Shqyrtues - OSHP.

OE ankues - B&D "Engineering" shpk-Prishtinë